




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	19.04.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1166/18
PËR/ZA/TO:	z. Sherif HOTI, Menaxher i zyrës së Prokurimit -Komuna e Obiliqit
CC:	z. Xhafer Gashi Kryetari i Komunës së Obiliqit
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: “Rregullimi i parkut në Obiliqin e vjetër” me nr. të prokurimit OB614/18/1800/521, nr. të brendshëm 614/18/013/521.

I nderuari z. Hoti,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin: **“Rregullimi i parkut në Obiliqin e vjetër”** me nr. të prokurimit OB614/18/1800/521, nr. të brendshëm 614/18/013/521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin **“Rregullimi i parkut në Obiliqin e vjetër”** me nr. të prokurimit OB614/18/1800/521, nr. të brendshëm 614/18/013/521, në mënyrë që të

respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), me datë 13.04.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1166/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull “**Rregullimi i parkut në Obiliqin e vjetër**” me nr. të prokurimit OB614/18/1800/521, nr. të brendshëm 614/18/013/521, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Obiliqit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike të llojit punë, me vlerë të mesme të parashikuar 140,000.00€.

Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vërejtur se tek rubrika **III.2.2. Përshtatshmëria profesionale tek kërkesa 4**, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që Operatorët ekonomik duhet të kenë Certifikatat në fushën e ndërtimit: a) Certifikata ISO 9001-2008; b) Certifikata ISO 14001-2015; c) Certifikata ISO 18001-2007. **Në rast të konzorciumit secili anëtarë duhet të paraqesë certifikaten e mësipërme..** Kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se është në kundërshtim me nenin 71 paragrafin 4 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në **nenin 71 paragrafi 4** “ Nëse një tender dorëzohet nga një grup i Operatorëve Ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij Ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij Ligji. “ Çdo kërkesë e vendosur nga një Autoritet Kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij Ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.“ Bazuar në këtë Ligj kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose licenca hyn në kuadër të përshtatshmërisë profesionale nenin 62 paragrafi 2, andaj kërkesa si më lartë përben shkelje të nenit 71 paragrafi 4.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimin e kënaqshëm me pajisje të tilla.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 71 Grupet e Operatorëve ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

